



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ___/___/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “Fastech”sh.p.k

* * *

Procedura e prokurimit: “Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim I atyre ekzistuese”

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-15001-03-25-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje pajisje kompjuterike për KNK dhe rinovim I atyre ekzistuese”me fond limit 9,990,000 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh me afat ekzekutimi 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. C.C.S sh.p.k

J61901033C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 7,553,330 (shtatë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë)lekë pa tvsh.

2. Fastech sh.p.k

J81609010U

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 8,477,700(tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind)lekë pa tvsh.

3. PC STORE sh.p.k

L01606034A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 8,565,000(tetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë)lekë pa tvsh.

4.BNT Electronics sh.p.k

J61817047D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 8,837,500(tetë milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. C.C.S sh.p.k	J61901033C
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera 7,553,330 (shtatë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të kualifikimit pika 1)a dhe pikën ç)ka kërkuar si më poshtë cituar:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

Për të përmbushur plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik C.C.S sh.p.k ka paraqitur ne sistemin elektronik deklararaten mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (shtojca 6) si dhe shtojcen 1(formulari i ofertës ekonomike).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë pikë K.V.O konstaton se deklaratat e paraqitur nga operatori ekonomik nuk janë sipas formatit të hartuar e miratuar nga A.P.P si dhe DST te publikuar në sistemin elektronik për këtë procedurë prokurimi te shpallur nga AK.

Referuar ofertës ekonomike të dorëzuar në sistemin elektronik nga operatori ekonomik C.C.S sh.p.k për këtë procedurë prokurimi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta është shprehur vetëm me shifra dhe jo me fjalë siç e kërkon formati i DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik C.C.S shpk nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit te DST që APP ka publikuar ne ëeb app.gov.al dhe që jane të detyruara për zbatim nga çdo AK në procedurat e vitit 2019 e në vijim.

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 1, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, KVO vlereson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori C.C.S shpk nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi.

Citojmë se shprehja me fjalë tek formulari i ofertës është detyruar me qëllim për ti paraprirë gabimeve të mundshme të vlerave numerike të ofertës.

Detyrimi i plotësimit të formularit të ofertës me fjalë rrjedh nga rregullat e prokurimit dhe formati i dokumentave të tenderit.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik C.C.C sh.p.k do të

konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Fastech”sh.p.k se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 8,477,700(tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind)lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a,Drejtoria e Prokurimeve sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.05.2019**

Ankesa: JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____